

VENDIM
Nr. 4, datë 17.2.2014

PËR RINOVIMIN LICENCE SHA “UJËSJELLËS KANALIZIME TEPELENË”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/ “a”, të nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik sh.a. “Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë”, me:
 - Drejtues ligjor: Arben Kaçorri,
 - Drejtues teknik: Amarildo Tola.
2. Operatori sh.a. “Ujësjiellës-Kanalizime Tepelenë” autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
 - Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Tepelenë, Memaliaj; komunat: Qesarat, Kurvelesh, Krahës, Buz, Lopës, Luftinjë, Qendër F. Memaliaj, Qendër Tepelenë
4. Kjo licencë është e vlefshme deri më datën 2.4.2017, siç është përcaktuar në vendimin e KKRR nr. 16, datë 3.4.2013.

KRYETARI
Avni Dervishi